

Analiza e tregut 2024

Tregu Evropian për Bimët Mjekuese Aromatike dhe Produkte Pyjore
Jo Drusore organike nga Kosova



Toralf Richter (FiBL), Faton Nagavci, Zana Lika (Organika)

Shtator 2024

Përmbajtja

Përmbajtja	I
1. Përmbledhje ekzekutive	2
2. Hyrje	3
3. Metodologjia	4
4. Situata në anën e furnizimit në Kosovë	4
5. Analiza e tregut ndërkombëtar	8
5.1 Shifrat kryesore të prodhimit organik nga Evropa	8
5.2 Shifrat kryesore të tregjeve organike nga Evropa	9
5.3 Evropa si rajon i synuar për eksporte organike nga Kosova	11
5.4 Pejsazhi konkurrues për prodhime organike nga Kosova	13
6. Trendët dhe shifrat e tregjeve kryesore të synuara për prodhimet organike nga Kosova.....	16
6.1 Gjermania	16
6.2 Zvicra.....	18
6.3 Italia.....	19
6.4 Franca.....	21
6.5 Përgjigja nga importuesit e intervistuar nga vendet e synuara Evropiane	22
7. Trendët dhe tregu për BMA dhe PPJD	23
8. Pasqyra dhe perspektiva e biznesit.....	26

Referencat

Anekset

I. Përmbledhje ekzekutive

Studimi shqyrton zhvillimin dhe perspektivat e sektorit kosovar për Bimë Mjekuese Aromatike (BMA) dhe Produktet Pyjore Jo Drusore (PPJD) të certifikuara organikisht në raport me Evropën si tregu kryesor i synuar.

Kosova ka një mjedis të pasur natyror që favorizon grumbullimin e BMA-ve të ndryshme të egra si dhe kultivimin e tyre. Për më tepër, Kosova është ndër vendet me zonat më të mëdha për grumbullimin e bimëve organike të egra në mbarë botën. Zonat e certifikuara organike në vend janë rritur deri në vitin 2022, por numri i operatorëve organikë është ulur në të njëjtën periudhë. Gjithashtu, vëllimi i prodhimit dhe eksportit të BMA-ve organike ka rënë gjatë viteve të fundit. Ka shumë arsye pse ka rënë numri i operatorëve organikë të certifikuar (barra administrative, kërkesat për certifikim, mungesa e komunikimit të nevojshëm midis prodhuesve dhe klientëve, mungesa e ndikimit të certifikimit në çmimet e shitjes, rastet e shumta të de-certifikimit, opsionet më tërheqëse në bujqësinë konvencionale, mungesa e fuqisë punëtore sezonale). Fermat e certifikuara janë të lidhura me qendrat grumbulluese për BMA, të cilat mbulojnë tërë territorin e Kosovës.

Studimi analizon anën e ofertës në Kosovë, kushtet e tregut ndërkombëtar, pejsazhin konkurrues dhe trendët në tregjet kryesore të synuara për produktet organike kosovare. Sipas statistikave evropiane të importeve, Gjermania, Zvicra, Italia, Franca dhe disa vende të tjera janë identifikuar si tregje kryesore të synuara për eksportin e BMA-ve organike dhe PPJD-ve. Raporti tregon gjithashtu se Shqipëria, Gjeorgjia, Bosnja dhe Hercegovina dhe Serbia shfaqen si konkurrentë të drejtpërdrejtë në tregun evropian për këto produkte.

Janë identifikuar sfida të ndryshme për eksportuesit kosovarë, duke përfshirë çështjet e cilësisë, kostot e larta të certifikimit organik, mungesën e investimeve, migrimin nga viset rurale dhe rënien e grumbullimit të bimëve të egra. Për të eksportuar me sukses, prodhuesit kosovarë duhet të përmbushin standardet strikte të cilësisë dhe sigurisë dhe të jenë të lirë nga të gjitha llojet e mbetjeve, të cilat janë të dëmshme për shëndetin e njeriut ose të ndaluara si lëndë për t'u përdorur në bujqësinë organike.

Pavarësisht nga tendencat e konsolidimit në tregun evropian për produktet organike, ka ende një potencial të pa hulumtuar dhe të mbuluar plotësisht për rritjen e eksportit bazuar në një kërkesë të lartë për ushqime të qëndrueshme, të shëndetshme dhe për mirëqenie dhe produkte të kujdesit dhe kozmetikës natyrale, veçanërisht për shkak të tendencave të tilla si burime të qëndrueshme të bazuara në vlera, sjellje e konsumatorëve me vetëdije për shëndetin dhe kërkesa për produkte me etiketa të pastra (p.sh. kozmetikë natyrale). Prandaj, do të mund të kishte një potencial për një rritje të eksporteve të BMA-ve dhe PPJD-ve nga Kosova, nëse parametrat e

cilësisë dhe çmimit konkurrojnë me standardet ndërkombëtare dhe përmbushin pritjet e importuesve.

2. Hyrje

Kosova, e vendosur në zemër të vendeve të Ballkanit Perëndimor, posedon një mjedis të pasur natyror të favorshëm për aktivitetet e grumbullimit të Produkteve Pyjore Jo Drusore (PPJD) të egra por edhe për kultivimin e Bimëve Mjekuese Aromatike (BMA) të shumëllojshme.

Vendi ka më shumë se 20 vite zhvillim të sektorit organik me një sektor që ka shumë mundësi për rritje të eksportit dhe tregjeve vendase. Në fakt, zona organike e certifikuar është rritur ndjeshëm. Ndërsa në vitin 2009 kishte shumë pak hektarë të certifikuar për Bimë Mjekuese Aromatike (BMA) organike, deri në vitin 2022 sipërfaqja e certifikuar organike ishte rritur në gjithsej 518 hektarë me 43 operatorë organikë plus sipërfaqe të grumbullimit të bimëve të egra organike. Megjithatë, ndërsa zona e certifikuar organike është rritur, numri i operatorëve organikë ka rënë në të njëjtën periudhë dhe dinamika është ngadalësuar për arsye të ndryshme (shih kapitullin 4).

Megjithëse tregu i produkteve organike në Evropë ka treguar tendenca konsolidimi në vitet e mëparshme, kërkesa globale për produkte organike vazhdon të rritet, veçanërisht në fushën e qëndrueshmërisë, shëndetit dhe mirëqenies si forca shtytëse. Karshi kësaj, potenciali i sektorit të bujqësisë organike të Kosovës bëhet gjithnjë e më i rëndësishëm..

Ky studim tregu synon të paraqesë fakte të zhvillimit të anës së ofertës dhe kërkesës së zinxhirit të furnizimit të BMA-ve organike. Studimi pasqyron edhe kushtet e kornizës politike, ekonomike dhe të ofruesit të shërbimeve për një zhvillim të favorshëm të grupeve. Për më tepër, ai përshkruan dinamikën në tregun evropian dhe forcat konkurruese që formësojnë sektorin organik të BMA-ve në Kosovë. Duke shqyrtuar dimensionet të ndryshme të tregut, nga prodhimi deri te preferencat e konsumatorëve, studimi përpiket t'u ofrojë palëve të interesuara njohuri të prekshme për të përshkuar dhe të përfituar nga mundësitë.

Studimi fillon me përshkrimin e zhvillimit të anës së ofertës në Kosovë, pasuar nga prezantimi i të dhënave të eksportit organik dhe një analizë e vendeve kryesore konkurruese për Kosovën në eksportimin e BMA-ve organike dhe PPJD-ve në tregun e BE-së. Së fundi, tregu në vendet e BE-së përshkruhet duke përfshirë tendencat, perspektivat dhe pritjet e blerësve.

3. Metodologjia

Studimi bazohet kryesisht në metodat dhe burimet e përdorura të mëposhtme:

- Hulumtim i materialeve (burime të ndryshme),
- Ana e prodhimit të analizës së të dhënave (Burimet: FiBL/“Bota e Bujqësisë Organike”; Basri Hyseni/”Studim i Sektorit të Produkteve Pyjore Jo Drusore dhe Bimëve Mjekuese Aromatike”),
- Pamjet e vendeve të tregjeve kryesore importuese evropiane /burime të ndryshme),
- Analiza e të dhënave për import të BMA-ve organike dhe PPJD në BE dhe Zvicër (Burimi: EU TRACES, Bio Suisse),
- Intervista me importues të përzgjedhur të BMA-ve organike në Kosovë).

4. Situata në anën e furnizimit në Kosovë

Grumbullimi i PPJD-ve në Kosovë ka një traditë të gjatë. Produktet e grumbulluara eksportohen si produkte organike të certifikuara kryesisht në BE dhe Zvicër. Meqenëse kërkesat nga vendet importuese nuk mund të mbuloreshin vetëm nga grumbullimi, përpunuesit dhe qendrat e grumbullimit gjithashtu filluan të kontraktin fermat për të kultivuar BMA. Gjatë viteve të fundit është rritur gradualisht edhe oferta e produkteve të përpunuara apo edhe të gatshme si çajrat dhe erëzat.

Sipas MBPZHR (2024), në Kosovë 544 ha janë certifikuar për organike në vitin 2023 nga gjithsej tri organet ushtruese të certifikimit të Kosovës. Kjo përbën 0.1% të gjithsejit të tokës bujqësore. Në atë vit janë certifikuar 39 operatorë organikë (shih Figurën 1 dhe Tabelën 1). Pjesa më e madhe e tokës është e kultivuar me BMA .

Tabela 1: Shifrat kryesore të prodhimit organik në Kosovë në vitin 2023

Vend	Sipërfaqja organike (ha)	Sipërfaqja Organike/totale (%)	Operatorët organik
Kosova	544	0.1	39

Burimi: MBPZHR (2024)

Tabela 2: Shifrat kryesore të prodhimit organik në Kosovë në 2023 sipas grupeve të produkteve (pa grumbullimin e të egrave)

Grupi prodhues	Sip. organike (ha)	Vëllimi i prodhimit (ton)	Numri i Operatorëve organik
BMA	298.19	1339.33	27
Grurë	169.54	416.16	4
Arra	22.80	4.00	2
Aronia	8.10	30.25	3
Mjedra	3.51	65.15	1
Fara kungulli	2.96	73.00	1
Qershi	0.15	0.05	1
Jonxhë	39	-	1
Kërpudha	-	12.95	2
	544.25	1940.89	

Burimi: MBPZHR (2024)

Tabela 2 paraqet sipërfaqen e prodhimit dhe vëllimet e prodhimeve organike të kultivuara në Kosovë në vitin 2023. Sipas statistikave të MBPZHR-së, BMA ka rol udhëheqës sa i përket sipërfaqes së certifikuar, pasuar nga gruri dhe arra. Sa i përket vëllimeve të prodhimit, prijnë BMA pasuar nga gruri, farat e kungullit dhe mjedrat.




Figura 1: Zhvillimi i treguesve kryesor organik në Kosovë ndërmjet viteve 2020 dhe 2022.

Burimi: Bota e Bujqësisë Organike (2024) dhe MBPZHR (2024)

Numri i prodhuesve organikë dhe zona organike u zvogëluar ndërmjet viteve 2020 dhe 2023, tendencë e cila ende nuk është ndërprerë, megjithëse eksportet e produkteve organike në BE janë rritur pak në të njëjtën periudhë (kryesisht për shkak të PPJD-së së grumbulluar të egër).

Raporti ORGANIKA – sektori PPJD BMA 2023 i realizuar nga shoqata Organika me mbështetjen e konsulentit Basri Hyseni dhe financiar nga SwissContact në Kosovë, ofron një pasqyrë të thellë të prodhimit të Produkteve Pyjore Jo Drusore (PPJD) dhe Bimëve Mjekuese Aromatike (MAP) si dhe mjedisin e biznesit.

Sipas studimit, kushtet e kornizës për sektorin e BMA-ve organike dhe PPJD mund të përshkruhen si në vijim:

Punësimi

Ka një rënie të lehtë të punësimit me 298 punëtorë me orar të plotë dhe 769 punëtorë sezonal, që tregon një zhvendosje drejt grup moshave më të pjekura të punëtorëve.

Certifikimi

Numri i operatorëve të certifikuar për prodhimin organik është ulur krahasuar me vitet e mëparshme. Megjithatë edhe certifikata të tjera si GLOBAL G.A.P., HACCP ose UTZ përdoren pjesërisht për të furnizuar tregjet importuese.

Kapacitetet përpunuese

Edhe pse kapacitetet e përpunimit mbetën stabile ka një rënie të shfrytëzimit të tyre funksional.

Prodhimi dhe shitja

Gjithsej 2.621 tonë PPJD dhe 118 tonë BMA janë grumbulluar dhe shitur në vitin 2023 duke krijuar të hyra të përgjithshme prej 16.5 milion EUR.

Investimet

Janë vërejtur investime të kufizuara, të ndikuara nga mungesa e skemave të granteve në Kosovë për vitin 2023 dhe nga mbështetja e akterëve të sektorit për grante. Megjithatë operatorët përpiqen të përqendrohen në rritjen e produktivitetit, zhvillimin e produkteve të reja, depërtimin në tregje të reja, shtimin e vlerës së produkteve nëpërmjet përpunimit dhe promovimit të produkteve në nivel ndërkombëtar.

Emigrimi nga viset rurale

Emigrimi masiv i të rinjve drejt zonave urbane apo jashtë vendit përbën një sfidë të rëndësishme për zhvillimin e sektorit.

Prodhimi i kontraktuar

Ka një rritje prej 14% të prodhimit të kontraktuar, që tregon një lëvizje drejt marrëveshjeve më të formalizuara të shitjeve. Prodhimi i kontraktuar dhe prodhimi në grup të organizuar të Operatorëve organik (p.sh. si kooperativa) do të arrijë më shumë rëndësi në të ardhmen e afërt për bërjen e investime në prodhim organik dhe certifikim të përballueshëm për bujqit e vegjël.

Bazuar në vëzhgimet dhe diskutimet e veta me palët e interesuara në vitet e mëparshme në Kosovë, duhet të adresohen çështje shtesë për të përshkruar kushtet kornizë të zhvillimit të sektorit organik.

Mungesa e njohurive dhe ekspertizës

Ka shumë parametra cilësorë, të cilët duhen plotësuar në lidhje me cilësitë ndijore, fizike, mikrobiologjike dhe kimike të produkteve, aspektet ligjore dhe certifikuese ose në lidhje me praktikën e aplikuara pas vjeljes dhe materialet e përdorura të ambalazhimit. Mosplotësimi i kërkesave mund të çojë në refuzim të produkteve të eksportuara ose ulje të çmimeve dhe për pasojë mund të ulë motivimin e bujqve për të vazhduar me prodhimin organik të BMA-ve.

Sot, në pak nga produktet e vjela gjenden mbetje të *tropan alkaloideve* ose *alkaloideve pirrolizidine* ose *nikotinës*, të cilat mund të dëmtojnë shëndetin e njeriut gjatë konsumimit të tij.

Kostot e larta dhe pengesat ekonomike

Certifikimi organik mund të jetë i shtrenjtë, duke përfshirë kostot e inspektimit, tarifën e certifikimit dhe përputhshmërinë me standardet organike. Këto kosto mund të pengojnë bujqit e vegjël që të kalojnë në bujqësi organike, ku asnjë tregtar apo fond publike nuk do t'i mbulonte këto kosto. Në të kaluarën e afërt këto shpenzime janë mbuluar nga projektet e donatorëve ndërkombëtarë. Pa mbështetje të jashtme financiare, qoftë nga donatorët, qoftë nga blerësit, është e paqartë se sa nga bujqit organikë do të vazhdojnë me prodhimin organik të certifikuar.

Përveç kësaj, bujqësia organike shpesh përfshin kosto fillestare më të larta për shkak të nevojës për farëra/fidane organike, plehra organike dhe inpute të tjera. Për më tepër, bujqësia organike zakonisht kërkon më shumë punë, gjë që mund të rrisë kostot e përgjithshme të prodhimit. Dhe resurset e punës nuk janë vetëm një faktor kostoje, ato mungojnë siç u përshkruan më parë në shumë nga vendet rurale ku tradicionalisht bëhet kultivimi i BMA-ve dhe grumbullimi i egër.

Sipas eksportuesve nga Kosova edhe likuiditeti financiar është një problem serioz pasi klientët jashtë paguajnë shumë vonë dhe qasja në financa në baza vendore është e kufizuar.

Rënia e përgjithshme e grumbullimit të egër

Shpyllëzimi, degradimi i tokës dhe ndryshimet klimatike mund të zvogëlojnë disponueshmërinë dhe sasinë për perimetër të grumbullimit të PPJD-ve si kërpudhat, BMA ose pemët manore. Rënia e njohurive tradicionale për grumbullimin e egër dhe mungesa e resurseve njerëzore në viset rurale mund të rezultojë që më pak njerëz të angazhohen në vjelje të qëndrueshme. Përveç kësaj, brezat e rinj mund të jenë më pak të interesuar ose më pak të ditur për praktikatat tradicionale të grumbullimit të egër ose madje nuk janë fare të interesuar të praktikojnë grumbullimin e egër.

Faktorët shoqëror dhe demografik

Një popullatë e moshuar bujqësore në Kosovë mund të jetë më pak e gatshme ose më pak e aftë të adoptojë teknika të reja të bujqësisë organike ose të investojë në lloje të reja të kulturave. Për bujqit e rinj, perspektivat ekonomike të prodhimit në shkallë të vogël të BMA-ve mund të mos jenë mjaft tërheqëse. Përveç kësaj, migrimi në viset urbane ose në vende të tjera për mundësi më të mira ekonomike rezulton në mungesë të fuqisë punëtore, duke e bërë të vështirë ruajtjen e praktikave të bujqësisë organike intensive të punës ose grumbullimit të egër.

Perspektivat dhe pasqyra për sektorin

Në përfundim, sektori PPJD dhe BMA në Kosovë tregon potencial për rritje dhe zgjerim të eksportit, por në këtë moment ballafaqohet edhe me ndryshime të konsiderueshme në anën strukturore, teknike, të fuqisë punëtore dhe financiare që duhet adresuar.

5. Analiza e tregut ndërkombëtar

Produktet nga kultivimi i BMA-ve organike dhe grumbullimi i egër eksportohen kryesisht në Evropë. Prandaj, raporti do të përqendrojë zhvillimin e eksportit dhe tregtisë në këtë rajon dhe trendët në tregun organik dhe ndërmjet konsumatorëve në Evropë.

5.1 Shifrat kryesore të prodhimit organik nga Evropa

Gjatë tri dekadave të fundit, ushqimi dhe bujqësia organike janë në rritje të vazhdueshme nga viti në vit në të gjithë BE-në. Tregu organik i BE-së ishte shumë dinamik në të kaluarën me ritme rritjeje që ndryshonin midis vendeve.

Në Evropë, 18,5 milionë hektarë u menaxhuan në mënyrë organike në vitin 2022, me BE-në që llogaritet për 16,9 milionë hektarë. Franca ka pozitën udhëheqëse për sa i përket tokës bujqësore nën menaxhim organik, me afro 2,9 milion hektarë, e pasuar nga Spanja (2,7 milion hektarë), Italia (2,3 milion hektarë) dhe Gjermania (1,9 milion hektarë). Këto katër vende së bashku përbëjnë më shumë se gjysmën e tokës bujqësore organike evropiane.

Toka bujqësore organike në Bashkimin Evropian rritet në mënyrë të qëndrueshme me rreth 1% në vit. Megjithatë, për të arritur qëllimin e vetë BE-së për të pasur 25 për qind tokë bujqësore organike deri në vitin 2030, do të kërkohej një rritje vjetore prej 10 për qind. Mbetet e pasigurt nëse prodhimi vendor në BE dhe me këtë edhe vetë-mjaftueshmëria do të rritet ndjeshëm gjatë viteve të ardhshme për të arritur qëllimin.

Në vitin 2022, toka bujqësore organike në Evropë përbënte 3,7 për qind të gjithsej tokës bujqësore ndërsa në Bashkimin Evropian përbënte 10,4 për qind, pra veçanërisht në vendet e Evropës Lindore, të anëtarësuara në BE, toka bujqësore organike përfaqëson një përqindje dukshëm më të ulët.

Në Evropë, pothuajse gjysma e tokës bujqësore organike përdoret për kulturat lavërtare. Megjithatë, BMA-të, siç kultivohen kryesisht në Kosovë, ende nuk kanë ndonjë rëndësi statistikore në anën e prodhimit në Bashkimin Evropian. Prandaj, ekziston nevoja për të importuar BMA nga rajonet jashtë BE-së dhe vende si Kosova.

Për sa i përket fermave organike, janë më se 480.000 prodhues organikë në Evropë, me pothuajse 420.000 në BE, me numrin më të madh në Itali (82.593). Numri i prodhuesve po rritet ngjashëm me tokën bujqësore të certifikuar.

Në vitin 2023 ishin rreth 92.000 përpunues organikë në Evropë me tendencë të rritjes. Vendi me numrin më të madh të përpunuesve ishte Italia (23/602).

Zhvillimi i sektorit organik në Evropë është i rrethuar nga një mbështetje e rëndësishme dhe ambicioze e politikave. Në maj 2020, Strategjia *Farm to Fork* (Nga Ferma te Piruni) e Komisionit Evropian përmend prodhimin organik si një sektor kyç për të arritur ambiciet ushqimore të Marrëveshjes së Gjelbër Evropiane. Strategjia thotë se "Tregu për ushqimin organik është vendosur të vazhdojë të rritet ndërsa bujqësia organike duhet të promovohet më tej". Si pjesë e kësaj strategjie, Komisioni publikoi Planin e Veprimit Organik 2021-2027, i cili synon të rrisë kërkesën dhe ofertën organike.

5.2 Shifrat kryesore të tregjeve organike nga Evropa

Tregu organik i BE-së është dinamik me ritme rritjeje që ndryshojnë midis vendeve të ndryshme. Zhvillimi i përgjithshëm i vazhdueshëm pozitiv i tij shkaktohet nga një kombinim i faktorëve të ndryshëm. Përveç karakterit inovativ të ushqimit organik dhe bujqësisë, vazhdon mbështetja në rritje e politikave dhe kërkesa në rritje e qytetarëve evropianë për prodhim ushqimor me cilësi të lartë dhe të qëndrueshme, pavarësisht situatës gjeopolitike dhe luftës së vazhdueshme në Ukrainë.

Në vitin 2022 shitjet organike me pakicë në Evropë u vlerësuan në 53,1 miliardë euro, me 45,1 miliardë euro në BE, duke e bërë BE-në tregun e dytë më të madh të vetëm për produktet organike në botë, pas Shteteve të Bashkuara. Gjermania kryeson tregun evropian me 15,3 miliardë euro në shitje me pakicë të produkteve organike, duke e bërë atë tregun e dytë më të madh në botë.

Në nivel global, vendet evropiane kryesojnë në aksionet e shitjeve të ushqimit organik si përqindje e tregjeve të tyre përkatëse të ushqimit. Danimarka ka pjesën më të lartë globale të tregut organik me 12,0 përqind, pasuar nga Austria me 11,5 përqind dhe Zvicra me 11,2 përqind.

Në vitin 2022, konsumatorët evropianë shpenzuan mesatarisht 64 euro për ushqim organik për person (BE: 102 euro). Shpenzimet e konsumatorëve për frymë për ushqim organik janë dyfishuar gjatë dekadës së fundit. Konsumatorët zviceranë dhe danezë kryesuan listën, duke shpenzuar më shumë për ushqim organik për person në vit me 437 dhe 365 euro, respektivisht.

Në Figura 2 jepet një pasqyrë e figurave kryesore të sektorit organik dhe tregut në Evropë.




Figura 2: Pasqyra e shufrave kryesore të sektorit organik dhe tregut në Evropë. Burimi: FiBL

5.3 Evropa si rajon i synuar për eksporte organike nga Kosova

Për shkak të madhësisë së tregut dhe afërsisë së tij, Evropa është tregu më i madh i eksportit të produkteve organike nga Kosova (BE dhe Zvicra), veçanërisht në vendet gjermano folëse. Arsyeja për këtë nuk është vetëm madhësia e tregjeve organike në vendet gjermanisht folëse. Kjo është edhe për shkak të lidhjeve personale të shumë njerëzve nga Kosova. Gjatë luftës, shumë njerëz ikën në vendet gjermanisht folëse dhe krijuan një rrjet marrëdhëniesh private dhe të biznesit atje që ekziston edhe sot. Përveç kësaj, diaspora në këto vende është veçanërisht e madhe.

Kosova ishte në vendin e 78-të të të gjitha vendeve eksportuese në BE në vitin 2023 për sa i përket vëllimit të tregtuar. Meqenëse pjesa më e madhe e produkteve të eksportuara janë kryesisht të thara dhe produkte relativisht gjysmë të përpunuara lehtë BMA dhe PPJD, rangimi ndërkombëtar do të ishte më i lartë për sa i përket vlerës së eksportit (nuk ka shifra vlere të disponueshme në nivel evropian).

Tabela 3 ilustron zhvillimin e vëllimeve të eksportuara ndërmjet vitit 2018 dhe 2023 në BE. Vendet kryesore të eksportit për Kosovën në vitin 2023 ishin Gjermania, Austria, Holanda dhe Kroacia.

Tabela 3: Vëllimet e eksportuara të prodhimeve organike nga Kosova në BE në ton sipas vendeve

Vendi importues	2018	2019	2020	2021	2022	2023
Gjermania	139	268	258	335	243	225
Austria	86	79	72	61	43	78
Holanda	1	0	20	0	13	66
Kroacia	0	0	0	37	50	30
Republika Çeke	159	140	0	0	0	4
Polonia	0	0	0	0	3	2
Italia	0	0	3	9	0	2
Sllovenia	0	0	0	40	18	0
Latvia	0	0	0	40	0	0
Belgjika	99	0	0	0	0	0
Hungaria	60	0	0	0	0	0
Franca	0	3	8	0	0	0
Gjithsej	544	489	361	522	370	408

Burimi: EU TRACES, 2024

Duke analizuar periudhën 2018-2023, gjithsej vëllimet e eksportuara nga Kosova drejt BE-së kanë rënë nga 544 në 408 ton. Kategoria kryesore e produkteve të eksportuara nga Kosova janë BMA me 217 ton në vitin 2023. Grupet tjera përkatëse ishin boronica, mjedra, pemët arnore dhe pemët e thata (shih Tabela 4). Edhe pse vëllimi i eksporteve në BE ka rënë nga viti 2018 deri në vitin 2023, vëllimet e eksportuara janë rritur për shumicën e grupeve të produkteve ndërmjet viteve 2020 dhe 2023, por ndryshon nga viti në vit.

Tabela 4: Pasqyra e grupeve të produkteve të eksportuara nga Kosova në BE nga viti 2020 deri në vitin 2023

Grupet e produkteve	2020	2021	2022	2023
BMA	208	328	222	217
Boronica (<i>vaccinium myrtillus</i>)	20	40	13	66
Pemë bërthamore, thelbih dhe perimet	19	24	28	37
Mjedra	0	0	0	37
Pemë të thara	34	16	40	25
Mollë të thara	2	25	22	12
Perime të thara	61	12	11	6
Erëza, të shtypura	0	0	0	4
Trumzë e egër	0	0	0	2
Çaj i gjelbër në paketime direkte prej > 3 kg	0	0	0	2
Dëllinja e zezë dhe farëra të <i>anason</i> , <i>badian</i> , <i>caraway</i> ose kopër	7	74	34	0
Kultura vajore dhe fruta vajore	11	3	0	0
	361	522	370	408

Burimi: EU TRACES, 2024

Përveç BE-së, Zvicra është një treg i rëndësishëm final i synuar për produktet organike nga Kosova me 9,6 tonë në vitin 2023. Produktet kryesore organike të certifikuar të eksportuara në Zvicër janë nenexhiku, rigoni, lulja e blirit dhe dëllinja (shih Tabela 5). Në total, vëllimet e eksportuara në Zvicër u zvogëluan në mes të viteve 2020 dhe 2023 dukshëm me minus 45 për qind pasi importuesi kryesor vendosi të vazhdojë marrëdhënien e eksportit vetëm me një kompani në Kosovë.

Tabela 5: Pasqyra e grupeve të produkteve të eksportuara nga Kosova në BE ndërmjet viteve 2020 dhe 2023

Produktet	2020	2021	2022	2023
Menta	2.4	0.1	1.2	2.4
Rigoni	8.7	2.3	3.1	2.0
Lulja e blirit	0.0	0.0	1.0	1.5
Dëllinja	0.0	0.0	0.0	1.0
Majdanoz	0.0	0.3	1.2	0.7
Kamomil	0.0	0.0	0.0	0.6
Pepermint	0.0	3.3	3.4	0.6
Melissa	2.6	0.2	1.0	0.5
Livanda	0.0	0.0	0.0	0.2
Boronicat / të egra	0.1	0.0	0.0	0.0
Fruti i shtogu	0.0	0.8	2.0	0.0
Ciani	0.0	0.0	0.0	0.0
Preshi	2.6	0.0	0.0	0.0
Gjethe mëllage të zezë	0.0	0.1	0.0	0.0
Lule mëllage të zezë	0.1	0.0	0.1	0.0
Lule kalendule	0.9	0.0	0.0	0.0
Gjithsej	17.4	7.1	13.1	9.6

Burimi: Bio Suisse, 2024

5.4 Pejsazhi konkurrues për prodhime organike nga Kosova

Në një anketë të importuesve organikë rreth imazhit të eksporteve organike nga Kosova në vitin 2020, janë identifikuar përparësitë dhe dobësitë krahasueset krahasuar me vendet e tjera burimore (furnizuese). Mbi të gjitha dobësitë e identifikuara duhet të adresohen në masat e zhvillimit të kapaciteteve për prodhuesit dhe eksportuesit.

Përparësitë krahasuese	Dobësitë krahasuese
- Vend furnizues me çmime të favorshme të produkteve - Klimë e favorshme dhe kushte natyrore për kultivimin e BMA-ve dhe grumbullimin e egër	- Cilësi e dobët e produkteve (përfshire çështjet me mbetjet), - Besueshmëri dhe fleksibilitet më i ulët i eksportuesve - Gamë më e ulët e produkteve organike të furnizuara nga Kosova

Vendet kryesore të eksportit dhe importit të BMA-ve organike

Në faqet e mëposhtme kryesisht përqendrohemi në eksportin e BMA-ve organike në BE.

Sipas *EU Traces*, Kosova eksporton BMA kryesisht në Gjermani dhe Austria (shih Tabela 6).

Tabela 6: Vendet kryesore në BE importuese të BMA-ve organike nga Kosova në vitet 2018 – 2023 me vëllim të eksportit në ton

Vendi importues	2020	2021	2022	2023
Gjermania	145	254	181	172
Austria	59	49	38	32
Kroacia	0	16	0	5
Çekia	0	0	0	4
Polonia	0	0	3	2
Italia	3	9	0	2
Bulgaria	0	0	0	0
Holanda	0	0	0	0
Gjithsej	207	328	222	217

Burimi: EU TRACES

Për të zhvilluar një analizë të konkurrencës me eksportuesit të BMA-ve nga vendet tjera, në një hap tjetër, eksportuesit kryesor të BMA-ve organike në BE janë paraqitur te Tabela 7. Më vonë gjatë analizës do të përqendrohemi vetëm në vendet tjera të Ballkanit Perëndimor, pasi që ato janë drejtpërdrejt të krahasueshme sipas kushteve të prodhimit dhe logistikës.

Tabela 7: Vendet kryesore eksportuese të BMA-ve organike në BE në vitet 2018 – 2022 me vëllim të eksportit në ton

Vendi eksportues	2018	2019	2020	2021	2022
Shqipëria	684	883	877	1'106	943
Gjeorgjia	112	114	181	190	268
Bosnja dhe Hercegovina	299	233	360	301	254
Kosova	200	266	207	328	222
Ukraina	23	21	43	96	171
Serbia	63	83	57	47	62
Republika e Kosovës	0	1	8	42	41
Republika e Maqedonisë Veriore	5	22	0	2	4

Burimi: EU Traces

Për sa i përket vëllimeve të eksportuara, Shqipëria është eksportuesi kryesor në BE, pasuar nga Gjeorgjia dhe Bosnja e Hercegovina. Kosova vijon në rangun e 4. Përderisa në vendet e Evropës Lindore si Gjeorgjia, Ukraina dhe Republika e Moldavisë vëllimet e eksporteve janë rritur gjatë viteve të fundit, në vendet e Ballkanit Perëndimor përfshirë Kosovën vëllimet e eksporteve po ngecin dhe madje, po bien.

Në paragrafët në vijim është paraqitur se në cilat vende Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina dhe Serbia eksportojnë BMA. Kjo analizë tregon vendet e synuara për të eksportuar nga Kosova e të cilat ende nuk janë hulumtuar apo eksportohet pak.

Analiza e konkurrencës – Ku eksporton Shqipëria BMA-të e saj organike?

Pasi që Shqipëria është eksportuesi më i madh i BMA-ve organike në EU dhe vend fqinj i Kosovës pjesërisht është edhe partner por edhe konkurrent kryesor i Kosovës në eksport të BMA-ve organike në tregun Evropian. Tabela 8 tregon se vilat vende të BE-së i furnizon Shqipëria me BMA.

Tabela 8: Vendet kryesore importuese të BE-së të BMA-ve organike nga Shqipëria në vitet 2018 – 2022 me vëllim eksporti në ton

Vendi importues	2018	2019	2020	2021	2022
Gjermania	400	510	485	570	501
Franca	126	169	75	110	120
Austria	78	116	124	150	112
Greqia	2	11	6	35	41
Polonia	3	17	39	41	39
Kroacia	18	30	24	76	38
Holanda	22	12	86	31	37
Italia	20	7	18	79	33
Republika Çeke	0	10	11	8	21
Spanja	14	0	9	6	0
Belgjika	0	0	0	0	2
Gjithsej	684	883	877	1'106	943

Burimi: EU TRACES

BMA-të organike të certifikuara, nga Shqipëria kryesisht eksportohen në Gjermani, Francë dhe Austri. Kështu që, përveç Gjermanisë dhe Austrisë, për Kosovën edhe Franca mund të bëhet potencialisht një pranues i rëndësishëm i BMA-ve organike. Vendet tjera që po ashtu importojnë produkte organike nga Shqipëria janë p.sh. Greqia, Polonia, Holanda, Italia dhe Republika Çeke.

Analiza e konkurrencës – Ku eksporton Bosnja dhe Hercegovina BMA organike?

Tabela 9 tregon se cilat vende të BE-së Bosnja dhe Hercegovina i furnizon me BMA.

Tabela 9: Vendet kryesore të BE-së importuese të BMA-ve organike nga Bosnja dhe Hercegovina në vitet 2018 – 2022 me vëllimin e eksportit në ton

Vendi importues	2018	2019	2020	2021	2022
Gjermania	236	160	269	204	183
Sllovenia	0	0	0	0	20
Franca	20	29	41	52	19
Austria	0	0	18	14	12
Kroacia	17	30	25	30	11
Spanja	0	0	0	0	5
Suedia	8	0	0	0	0
Polonia	10	0	3	0	0
Italia	8	13	3	0	3
Gjithsej	299	233	360	301	254

Burimi: EU TRACES

BMA-të e certifikuara organike nga Bosnja dhe Hercegovina kryesisht eksportohen në Gjermani, Slloveni, Francë, Austri dhe Kroaci.

Analiza e konkurrencës – Ku i eksporton Serbia BMA-të e saj organike?

Tabela 10 tregon se cilat vende të BE-së Serbia i furnizon me BMA.

Tabela 10: Vende kryesore të BE-së që importojnë BMA organike nga Serbia në vitet 2018 – 2022 me vëllim eksporti në ton

Vendi importues	2018	2019	2020	2021	2022
Gjermania	49	68	27	33	40
Danimarka	0	0	27	13	13
Franca	0	0	2	0	5
Italia	0	0	0	0	3
Sllovenia	0	7	0	0	0
Austria	2	8	1	0	0
Belgjika	0	0	0	1	0
Republika Çeke	12	0	0	0	0
Gjithsej	63	83	57	47	62

Burimi: EU TRACES

BMA-të e certifikuara organike nga Serbia kryesisht eksportohen në Gjermani, Danimarkë, Francë dhe Austri.

Analiza e tri vendeve kryesore konkurruese për Kosovën sugjeron që përveç tregjeve të synuara që aktualisht janë në fokus, vende si Franca apo Danimarka por edhe vendet fqinje në rajonin e Ballkanit mund të jenë tregje të ardhshme për BMA dhe PPJD nga Kosova.

6. Trendët dhe shifrat e tregjeve kryesore të synuara për prodhimet organike nga Kosova

Nën-kapitujt e mëposhtëm përshkruajnë madhësinë, dinamikën, karakteristikat dhe tendencat e vendeve kryesore të synuara.

6.1 Gjermania

Gjatë viteve të fundit, inflacioni dhe rritja e kostove të jetesës kufizuan fuqinë blerëse të konsumatorëve gjermanë. Në vitin 2022 si pasojë shitjet e produkteve organike pësuan ulje të lehtë. Por, pas një viti konsolidimi të tregut dhe rënies së lehtë të shitjeve organike me pakicë, në vitin 2023 tregu organik gjerman filloi të rritet sërish. Qarkullimi organik u rrit në vlerë prej 16 miliardë euro (shih Figura 3). Kjo përputhet me një pjesë të tregut organik prej 6,3%. Kjo e bën Gjermaninë tregun më të madh organik në Evropë dhe tregun e dytë më të madh organik në botë.




Figura 3: Zhvillimi i shitjeve organike me pakicë në vitet 2018 - 2023 në Gjermania (në miliardë EUR). Burimi: AMI 2024

Duke qenë se tregu gjerman tregoi tendenca në rritje përsëri në vitin 2023, shumica e konsumatorëve organikë mbeten të vetëdijshëm për çmimet dhe prirjen të blejnë produkte organike në vendet ku u ofrohen çmime relativisht të ulëta (shitësit me pakicë si p.sh. Aldi dhe Lidl dhe barnatoret tregojnë një parapëlqim më të madh për produktet organike të markave më

të lira të shitësve organikë në vend të markave më të shtrenjta të prodhuesve organikë – shih Figura 4). Si rrjedhojë, ai gjithashtu mban presionin e çmimeve të lartë tek furnitorët.




Figura 4: Zhvillimi i hiseve të tregut të brendeve organike të prodhuesit dhe shenjave tregtare të shitësve me pakicë të produkteve organike (brendet private). Burimi: AMI 2024

Figura 5 paraqet kanalet e tregut për blerjen e produkteve organike në Gjermani. Kryesisht supermarketet/diskontet kanë hise në treg, ndërsa janë rritur edhe kanalet tjera të shpërndarjes por vetëm në nivel minimal.



Figura 5: Pasqyrat e shpenzimeve të konsumatorëve organik sipas kanalit të tregut, Burimi: AMI, 2024

Pjesa e tregut organik në Gjermani ka rënë ndërmjet viteve 2020 dhe 2023 nga 6,8% në 6,2%, megjithëse shpenzimet e konsumit organik janë rritur nga 14,99 miliardë euro në 16,08 miliardë euro në të njëjtën periudhë. Arsyeja e mospërputhjes midis dy treguesve mund të shpjegohet nga zhvillimi i ndryshëm i çmimeve të produkteve konvencionale dhe organike. Çmimet e produkteve konvencionale janë rritur në këtë periudhë më shumë se çmimet e ushqimeve organike, gjë që ka bërë që të ulët pjesa e tregut të produkteve organike, megjithëse shpenzimet e konsumatorit për ushqimin organik ishin më të larta.

Zhvillimi i fundit

- Inflacioni dhe kostot e larta të jetesës e mbajnë fuqinë blerëse të ulët. Sipas një studimi të fundit, familjet që mund të përballonin pothuajse çdo gjë janë 38% e tërë popullsisë, që është më e ulët se në periudhën para fillimit të Covid-it dhe inflacionit. (shih Figura 6).
- Ndryshimi në kanalet e shpërndarjes - më shumë diskonte dhe barnatore si vende të preferuara për të blerë produkte organike. Dyqanet e specializuara organike humbasin më tej pjesën e tregut.
- Sa i përket grupeve prodhuese, më së shumti rritje janë prodhimet e qumështit dhe ato të mishit me bazë bimore.
- Qartazi shitje më të larta të produkteve me etiketë private, si Bioland dhe Naturland, sepse supermarketet Aldi dhe Lidl i promovojnë këto etiketa në asortimentet e tyre.
- Çmimet e konsumit organik dhe atij konvencional përafrohen për shkak të rritjes më të fortë të çmimeve për produktet konvencionale.
- Shkalla e konvertimit në bujqësinë organike mbetet në një nivel të ulët.
- Shumë paqartësi për sektorin organik për zhvillimin e kostove, rregulloreve ligjore dhe subvencioneve.
- Çmimet e prodhimit organik kanë mbetur të qëndrueshme (p.sh. mishi i derrit, produktet e qumështit, vezët) ose disa kanë rënë (drithërat p.sh.).




Figura 6: Vetëvlerësim i situatës financiare në vitet 2017-2023, Hisja e të gjitha ekonomive familjare në Gjermani në %. Burimi: AMI bazuar në GfK

Shifrat e tanishme tregojnë qartë: me gjithë një rritje të lehtë, sektori organik në Gjermani është ende shumë larg synimeve ambicioze të qeverisë gjermane: deri në vitin 2030, 30% të tokës së punuar bujqësore të bëjë tokë organike.

Një listë e importuesve gjermanë të BMA organike dhe PPJD gjendet në Aneks:

6.2 Zvicra

Në vitin 2023, konsumatorët zviceranë vazhduan të synonin produkte organike pavarësisht disponimit të dobësuar (shkak: inflacioni, rritja e çmimeve). Pjesa e tregut në tregtinë me pakicë

është rritur dhe tani është 11,6% (2022: 11,2%). Gjithsej shitjet organike duke përfshirë shitësit e specializuar me pakicë, marketingun e drejtpërdrejtë dhe kanalet e tjera të shitjes arritën në rreth 4,1 miliardë euro në vitin 2023, krahasuar me 3,9 miliardë euro në vitin 2022. Prandaj, ne e shohim prirjen afatgjatë drejt më shumë shitjeve organike në tregun e ushqimeve në Zvicër si të pathyer.

Dy kanalet dominuese të shpërndarjes për produktet organike në Zvicër janë zinxhirët e shitjes me pakicë Coop (42,5% e tregut) dhe Migros (32,8% e tregut) tashmë prej dekadash. Të gjitha kanalet e tjera, duke përfshirë diskontet dhe dyqanet organike kanë vetëm një rol marginal në tregun zviceran. (shih Figura 7).




Figura 7: Pasqyra e kanaleve të shpërndarjes për produkte organike në Zvicër në vitin 2023. Burimi: Bio Suisse

Në Zvicër ka importues të shumtë të regjistruar për produkte organike, duke përfshirë BMA dhe PPJD, të cilët janë përpunues ose produkte burimore për llogari të tregtarëve organikë me shumicë ose zinxhirëve të shitjes me pakicë.

Një listë e importuesve zviceranë të BMA organike dhe PPJD gjendet në Aneks.

6.3 Italia

Në Itali tregu i ushqimit organik në vitin 2023 ka arritur 5,5 miliardë euro dhe krahasuar me vendet e tjera ka treguar një rritje prej më se 5% (shih Figura 8). Produktet më organike janë

shitur përmes supermarketeve dhe diskonteve me 45% të tregut. Dinamika më e lartë është shënuar nga supermarketet dhe diskontet me një rritje prej rreth 8%.




Figura 8: Shitja e ushqimit organik në Itali në vitin 2023. Burimi: Università Politecnica Delle Marche

Hisja e tregut organik në vitin 2023 ka arritur në 3.3% (shih Figura 9).

Sinjalet e rimëkëmbjes së tregut vijnë si nga supermarketet ashtu edhe nga dyqanet e specializuara. Megjithatë, pjesa më e madhe e rritjes së vlerës në vitin 2023 ka ardhur si pasojë e inflacionit/rritjes së çmimeve për ushqimet organike dhe rritja e tregut organik ka qenë më e ulët se rritja e gjithmbarshme e tregut ushqimor për nga vlera. Gjithashtu nga ekspertët e tregut vendor është vërejtur që në vitin 2023 për herë të parë ka rënë asortimenti i produkteve organike në supermarkete.

Lista e importuesve italianë të BMA organike dhe PPJD gjendet në Aneks.




Figura 9: Zhvillimi i vlerës së shitjes dhe hiseve të tregut në supermarketë në Italia në vitet 2008 dhe 2023. Burimi: Università Politecnica Delle Marche, bazuar në të dhënat e AC Nielsen

6.4 Franca

Pas një periudhe të gjatë të rritjes së tregut në vitin 2022, shitjet organike në Francë kanë rënë për herë të parë me pothuajse 5%. Megjithatë, Franca mbetet tregu i dytë më i madh organik evropian dhe ka arritur në 12,08 miliardë euro (shih Figura 10). 715 milionë euro të tjera i dedikohen shitjeve nëpërmjet mensave dhe restoranteve. Kjo mënyrë shpërndarjeje është në rritje të fortë pavarësisht tendencave konsoliduese të kanaleve të tjera të tregut në Francë.




Figura 10: Zhvillimi i shitjeve organike me pakicë në Francë në vitet 2012 dhe 2022. Burimi: Agence Bio

Kanalet kryesore të shpërndarjes për produkte organike janë supermaketet dhe dyqanet organike, që përbëjnë rreth 80% të gjithëj shitjeve me pakicë (shih Figura 11). Hisja e tregut për produkte organike në vitin 2022 ka qenë 6,1%




Figura 11: Zhvillimi i shitjeve të ushqimit organik në Francë në vitet 2012 dhe 2022 sipas kanaleve të shpërndarjes.
Burimi: Agence Bio

Edhe në vitin 2023 ka vazhduar tendenca e një tregu organik të konsoliduar apo edhe me rënie të lehtë (-2.3%). Por ekspertët e tregut vendor parashikojnë një rritje të kërkesës sërish pas asaj periudhe konsolidimi.

Lista e importuesve francezë të BMA organike dhe PPJD gjendet në Aneks.

6.5 Përgjigja nga importuesit e intervistuar nga vendet e synuara Evropiane

Si pjesë e studimit janë realizuar intervista me importues të ndryshëm të BMA-ve organike dhe PPJD nga Kosova.

Faktet e mëposhtme janë përpiluar si përgjigje nga blerësit evropianë

Importuesit që kanë krijuar marrëdhënie tregu gjatë shumë viteve me furnitorët në Kosovë, kanë identifikuar pak eksportues, me të cilët bashkëpunojnë ngushtë në një nivel relativisht të lartë të kënaqësisë. Gjithashtu u përmend se marrëdhëniet me eksportuesit tjerë nga Kosova në të kaluarën është dashur të ndërpriten për shkak të çështjeve të përhershme të cilësisë.

Importuesit raportojnë për rritje të vëllimeve të blerjeve të BMA-ve ose PPJD-ve nga Kosova nga 20-30% në periudhën 2020 deri 2023 dhe presin një rritje të vazhdueshme prej 10-30% deri në vitin 2025. Por gjithashtu kanë thënë se vëllime edhe më të mëdha të blerjeve do të jenë të mundura për eksportuesit nga Kosova dhe furnizues të rinj mund të kontraktohen në rast të pritjeve të përshtatura të çmimeve dhe përmirësimeve të cilësisë nga ana e furnitorëve.

Kur importuesit janë pyetur për sfidat më të mëdha në importimin e BMA-ve nga Kosova, ata theksojnë se mbetjet e nikotinës, pesticideve si dhe PA janë faktorët kryesorë kufizues të cilësisë. Krahasuar me vendet e tjera furnizuese me BMA dhe PPJD, thuhet se vendet e Evropës Perëndimore si Gjermania, Austria janë pikë referimi për sa i përket cilësisë së produktit. Megjithatë, edhe një krahasim në vendet e Ballkanit Perëndimor duket i dobishëm, veçanërisht në lidhje me vjeljen e egër: Bosnja dhe Hercegovina ka ecur relativisht mirë kohët e fundit për sa i përket konformitetit dhe integritetit organik (p.sh. përmendet se Shqipëria dhe Bullgaria janë vende më kritike). Kosova konsiderohet të jetë ndër TOP 3 në renditjen e vendeve të Ballkanit Perëndimor. Megjithatë, thuhet gjithashtu se vetëm pak eksportues përmbushin kërkesat e importuesit sa i përket cilësisë, çmimit apo logjistikës në këtë moment.

Një importues i mundshëm gjithashtu ka raportuar se pse marrëdhëniet tregtare me eksportuesit nga Kosova kanë dështuar prapë. Në një rast, vëllimi i kërkuar ishte shumë i lartë për produktin e kërkuar në mënyrë specifike. Një arsye tjetër ishte se importuesi nuk pranon dërgesën e ofruar me *cargo* ajrore për arsye mjedisore. Në disa raste, pritshmëritë e çmimeve ishin shumë të ndryshme dhe së fundi gjithashtu mungesa e përgjigjes dhe problemet e përgjithshme të komunikimit janë raportuar si shkak i dështimit.

Në fund, importuesit janë pyetur edhe për tema për trajnime për operatorët MAP/PPJD për të rritur suksesin në çështjet e tyre të eksportit. Temat e mëposhtme janë përmendur më së shpeshti:

- Kontrolli efektiv i barojave
- Menaxhimi pas vjeljes
- HACCP (për të shmangur më shumë ndotje me TA/PA, nikotinë, pesticide)
- Shkathësitë për komunikim/bisedime.

Mund të konstatohet se ekziston një kërkesë potenciale dhe në rritje në Evropë për BMA dhe PPJD organike të certifikuara nga Kosova me parakushtin e skemave të përshtatura të biznesit, cilësisë dhe çmimit.

7. Trendët dhe tregu për BMA dhe PPJD

Kërkesa e tregut për produkte natyrale dhe organike po vazhdon të rritet. Megjithatë, rritja do të jetë më e ngadaltë se në vitet e mëparshme dhe vëllimi i përgjithshëm i nevojshëm i importit organik në Evropë do të ulet pak për arsye të ndryshme.

Megjithatë, trendët e mëposhtëm tregojnë një treg të fuqishëm dhe në zhvillim për BMA organike, me mundësi rritjeje, veçanërisht për prodhuesit dhe brendet që mund të përputhen me vlerat e konsumatorit rreth shëndetit, qëndrueshmërisë dhe furnizimeve etike.

Tregu për BMA organike dhe PPJD në Evropë ndikohet nga disa trendë kryesorë që pasqyrojnë një interes në rritje të konsumatorëve për shëndetin, mirëqenien dhe qëndrueshmërinë.

Furnizimi i qëndrueshëm dhe etik

Qëndrueshmëria është një shqetësim i madh për konsumatorët evropianë. Ka një kërkesë në rritje për BMA organike dhe PPJD që vilen në mënyrë të qëndrueshme, pa dëmtuar pyjet ose biodiversitetin.

Vetëdija për shëndetin

Konsumatorët evropianë po kërkojnë gjithnjë e më shumë produkte natyrale dhe organike për shkak të rritjes së vetëdijes për shëndetin dhe mirëqenien. Kjo nxitë kërkesën për BMA organike dhe PPJD në industri të ndryshme, duke përfshirë ushqimin dhe pijet, kozmetikën dhe farmaceutikën.

Produkte të pastra me etiketë

Ka një preferencë të fortë për produktet me etiketa të pastra ose natyrale, që do të thotë më pak aditivë dhe kemikalet, gjë që mbështet kërkesën për BMA organike dhe PPJD si përbërës.

Ilaçet bimore

Popullariteti i ilaçeve dhe suplementeve bimore është në rritje, i nxitur nga një preferencë për ilaçe natyrore në vend të substancave sintetike. BMA-të organike janë përbërësit kryesorë në këto produkte.

Ushqime funksionale dhe **nutraceutikalet**

Tregu funksional i ushqimit, i cili përfshin ushqime me përfitime të shtuara shëndetësore, po zgjerohet në Evropë. BMA-të organike dhe PPJD-të përdoren shpesh në këto produkte për vetitë e tyre promovuese të shëndetit. BMA-të po përdoren gjithnjë e më shumë si përbërës në ushqime funksionale (p.sh., ushqime me përfitime të shtuara shëndetësore) dhe në pije. Shembujt e njohur përfshijnë çajëra bimore, ushqime *energji*ke dhe pije të mbushura me ekstrakte bimore si shafrani i Indisë, menta dhe kamomili.

Gjithashtu nutraceutikalet po fitojnë gjithnjë e më shumë rëndësi në treg. BMA janë komponentë thelbësorë në tregun në rritje të produkteve ushqimore. Shumë bimë dhe barishte promovohen për përfitimet e tyre shëndetësore, të tilla si nxitja e tretjes, ulja e stresit ose rritja e funksioneve kognitive.

Rritja e tregut të vajrave esenciale

Ka një interes në rritje për aroma terapinë dhe përdorimin e vajrave esenciale, ku burimi organik është një prioritet. Vajrat esenciale që rrjedhin nga barishte si trumza, rigoni dhe nenexhiku janë të njohura si për kujdesin personal ashtu edhe për aplikimet e shëndetit.

Rritja e tregut të kozmetikës natyrale

Konsumatorët evropianë po favorizojnë gjithnjë e më shumë kozmetikën natyrale, ku BMA si livanda, rozmarina dhe aloe vera luajnë një rol të rëndësishëm. Industria e kozmetikës në Evropë po ndjek këtë prirje konsumatore dhe po kalon gjithnjë e më shumë drejt përbërësve natyralë dhe organikë. Këta përbërës shihen si më të sigurt dhe më të qëndrueshëm në krahasim me kemikali të sintetike.

Shqetësimet mjedisore

Konsumatorët evropianë janë shumë të vetëdijshëm për ndikimin mjedisor të blerjeve të tyre. Ekziston një kërkesë e madhe për BMA të kultivuara në mënyrë organike që janë nga burime të qëndrueshme dhe etike, duke mbështetur biodiversitetin dhe praktikën e tregtisë së drejtë.

Diversifikimi i produktit

Kompanitë po inovojnë duke zhvilluar produkte të reja të bazuara në BMA, duke përfshirë suplemente të reja dietike, pije dhe produkte për kujdesin e lëkurës, për t'iu përgjigjur nevojave dhe preferencave specifike shëndetësore.

Furnizimi lokal dhe zinxhirët e shkurtër të furnizimit

Për arsye të ndryshme, ka një lëvizje në rritje drejt gjetjes së BMA-ve dhe PPJD-ve në nivel lokal në Evropë. Ky trend drejtohet nga dëshira për të zvogëluar gjurmën e karbonit dhe për të siguruar gjurmueshmërinë e produktit. Për më tepër, konsumatorët evropianë preferojnë gjithnjë e më shumë produkte që mbështesin bujqit e vegjël vendor dhe teknikat tradicionale të vjeljes, veçanërisht në rajonet mesdhetare dhe alpine.

Produkte për rritjen e imunitetit

Pandemia COVID-19 ka nxitur një interes në rritje për produktet që besohet se mbështesin shëndetin e imunitetit, të tilla si BMA të caktuara si *echinacea* dhe shtogu.

Këta trendë tregojnë një treg të fuqishëm dhe në zhvillim për BMA organike dhe PPJD në Evropë, me mundësi të konsiderueshme për rritje, veçanërisht për prodhuesit dhe brendet që mund të

përputhen me vlerat e konsumatorit sa i përket shëndetit, dhe furnizimit të qëndrueshëm dhe etik.

Rregullore dhe standarde të sigurisë të rrepta

Bashkimi Evropian po zbaton rregullore më të rrepta për prodhimin organik dhe certifikimin e BMA-ve dhe PPJD sipas BE 2018/848. Përputhshmëria me këto rregullore është qenësore për hyrjen në treg. Përveç kësaj, importuesit kërkojnë standarde të larta të cilësisë dhe sigurisë. Produktet duhet të plotësojnë standarde të rrepta të cilësisë, duke përfshirë certifikatat e cilësisë dhe qëndrueshmërisë (GLOBAL G.A.P. HACCP, UTZ), për të pasur qasje më të mirë në tregun evropian. Gjithashtu, produktet duhet të jenë pa ndonjë TA/PA dhe mbetje të tjera të dëmshme.

Ndikimi i Ndryshimeve Klimatike dhe Humbja e Biodiversitetit

Ndryshimet klimatike po ndikojnë në disponueshmërinë e PPJD, veçanërisht në ekosistemet e ndjeshme si pyjet. Praktikrat e menaxhimit të qëndrueshëm janë thelbësore për të parandaluar mbivjeljen dhe ruajtjen e biodiversitetit. Ekziston një rritje e vetëdijes për rolin e PPJD dhe BMA në ruajtjen e biodiversitetit. Evropa po sheh nisma për të ruajtur speciet vendore dhe për të promovuar përdorimin e qëndrueshëm të resurseve pyjore.

8. Pasqyra dhe perspektiva e biznesit

Siç thekson studimi, sektori për Produkte Pyjore Jo Drusore (PPJD) dhe Bimë Mjekuese Aromatike (BMA) në Kosovë paraqet një perspektivë premtuese për rritje dhe zgjerim të eksporteve, veçanërisht në tregun evropian. Potenciali për rritjen e kërkesës për produkte organike të certifikuar BMA dhe PPJD nga Kosova varet nga përshtatja e skemave të cilësisë dhe çmimeve që përmbushin pritjet e importuesve evropianë.

Tregu evropian vazhdon të tregojë një interes në rritje për produktet organike, i nxitur nga tendencat e konsumatorit drejt furnizimeve të qëndrueshme, konsumit për qëllime shëndetësore dhe kërkesës për produkte me etiketa të pastra. Kjo paraqet një mundësi të rëndësishme për prodhuesit kosovarë.

Megjithatë, sektori përballë edhe me sfida të konsiderueshme, veçanërisht në frontin e punës dhe atë financiar. Popullsia e moshuar bujqësore në Kosovë mund të jetë më pak e prirur për të përvetësuar teknika të reja të bujqësisë organike, ndërsa brezat e ri mund të mos i shohin perspektivat ekonomike të prodhimit në shkallë të vogël të BMA-ve mjaft tërheqëse. Për më tepër, migrimi në zonat urbane ose në vende të tjera për mundësi më të mira ekonomike po ndikon në mungesë të fuqisë punëtore, e cila është thelbësore për ruajtjen e praktikave të bujqësisë organike me theks në fuqi punëtore ose mbledhjes së egër.

Për të trajtuar këto sfida dhe për të shfrytëzuar mundësitë e tregut, raporti sugjeron një fokus në disa fusha kryesore:

Standardet e Cilësisë dhe Sigurisë

Prodhuesit kosovarë duhet të sigurojnë që produktet e tyre të përmbushin standardet strikte të cilësisë dhe sigurisë që kërkohen nga tregu i BE-së. Kjo përfshin kontrollin efektiv të barojave të

këqija, zbatimin e sistemeve HACCP për të shmangur kontaminimin dhe respektimin e aspekteve ligjore dhe të certifikimit.

Investimet në Prodhim dhe Certifikim

Lëvizja drejt marrëveshjeve më të formalizuara të shitjeve, si prodhimi i kontraktuar dhe grupet e organizuara të Operatorëve Organik, pritet të fitojë rëndësi. Kjo do të ndihmojë që investimet në prodhim organik dhe certifikim të jenë më të përballueshme për fermerët e vegjël.

Trajnimi dhe Ngritja e Kapaciteteve

Ekziston nevoja për trajnime në fusha të tilla si kontrolli efektiv i barojave, HACCP dhe aftësitë e komunikimit/negocimit për të rritur suksesin e çështjeve të eksportit. Kjo do t'i ndihmojë operatorët të kuptojnë dhe të plotësojnë më mirë kërkesat e tregut evropian.

Diversifikimi i Tregut dhe Zhvillimi i Produktit

Kompanitë në këtë sektor planifikojnë të fokusohen në rritje të produktivitetit, zhvillim të produkteve të reja, depërtim në tregjet e reja, shtim të vlerës nëpërmjet përpunimit dhe promovim të produkteve në nivel ndërkombëtar. Ky diversifikim mund të ndihmojë zbutjen e rreziqeve dhe rritjen e hises së tregut.

Referencat

- Bio Suisse (2024): Informata personale për vëllimin e importit organik nga Kosova. Basel.
- EU Market briefs: https://agriculture.ec.europa.eu/cap-my-country/performance-agricultural-policy/studies-and-reports/analytical-briefs/market-analyses-and-briefs_en
- Hyseni, Basri (2024): Studim i Sektorit të Produkteve Pyjore JoDrusore dhe Bimëve Mjekuese Aromatike. Prishtinë.
- MBPZHR (2024): Shifrat kryesore të bujqësisë organike në Kosovë (informata të papublikuara.
- Importues të ndryshëm organik nga Evropiane (2024): Informata të Anonimizuara të bazuara në një anketë.
- Willer, Helga; Trávníček, Jan und Schlatter, Bernhard (Hrsg.) (2024) Bota e Bujqësisë Organike. Statistikat dhe Trendët e Ri 2024. Instituti Kërkimor për Bujqësi Organike FiBL dhe IFOAM - Organics International, Frick and Bonn

Aneks

Lista e importuesve / përpunuesve / tregtarëve të BMA dhe/ose PPJD

Gjermania

Alfred Galke GmbH

Allos GmbH

Dennree GmbH

AcanChia UG&Co.KG

Bionorica

Diafood GmbH

Dr. Willmar Schwabe Pharmaceuticals

Grüner Punkt Naturkost GmbH

Hamburger Gewürz-Mühle Hermann Schulz GmbH

HerbaPack GmbH

Henry Lamotte Oils GmbH

HERBARIA Kräuterparadies GmbH

Heinrich Klenk GmbH

InProPlant

Kräuter Mix GmbH

Lebensbaum (Ulrich Walther GmbH)

Lienig Wildfruchtverarbeitung GmbH

Martin Bauer Group

Marktgessellschaft der Naturland Betriebe mbH Öko Service GmbH

Pilze Wohlrab

Rapunzel

Rolker Ökofrucht GmbH

Tagtraum Tee Versand & Großhandels GmbH

Tee Gschwendner

Tegut

Völpel GmbH & Co. KG

Weiling GmbH

Worlée NaturProdukte GmbH

Austria

BioBalkan

Sonnentor

Waldland

Zvicrra

A.Vogel

Biodina

Delica AG (Migros)

Dixa AG

Erboristi Lendi

Kennel AG

Morga

TRAWOSA AG

Varistor

Holanda

Berrico FoodCompany B.V.

Biocore

Doens Food Ingredients B.V.

Franca

Herbier-du-diois

Italia

Bioorganic Srl

Sweetbio srl

Mbretëria e Bashkuar

Heath & Heather Tea

Kroacia

Terra-magnifica